

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vendin vakant për Specialist për ALUMNI në Sektorin e Komunikimit me Publikun në Drejtorinë e Komunikimit dhe Koordinimit pranë Rektoratit, si më poshtë:

Kritere të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për Specialist për ALUMNI në Sektorin e Komunikimit me Publikun.

- a) Të zotërojë diplomë të Universitare Master Profesional ose Master Shkencor në një nga fushat e arsimit të lartë.
- b) Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Specialist për ALUMNI në Sektorin e Komunikimit me Publikun.

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- b) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- c) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- d) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letrën e motivimit;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 27.05.2026 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.

II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Laborant” në Departamentin e Arkitekturës.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati janë:

1. Të ketë kryer arsimin e lartë dhe të ketë diplomë ne Programet e Integruara të ciklit të dytë të studimeve (ose ekuivalent me të). Preferohet të ketë kryer studimet në fushën e Arkitekturës dhe Urbanistikës
2. Të zotërojë, me dëshmi universitare, të paktën një gjuhë të huaj perëndimore. Preferohet gjuha angleze
3. Të ketë njohuri të mira të programeve bazë kompiuterike
4. Të ketë njohuri të mira të programeve kompiuterike që perdoren në fushën e Arkitekturës, si Autocad, Revit, Software Vizualizimi, paketat Adobe etj.
5. Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese, në shqip dhe në njërën prej gjuhëve të huaja perëndimore, si dhe të demonstrojë gatishmëri për realizimin e detyrave.
6. Të mos jetë larguar nga puna e mëparshme për masa disiplinore
7. Të ketë eksperiencë pune në fusha/pozicione të ngjashme

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara (Aplikantët që kanë kryer
 1. studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR)
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.
10. Portfolio që ilustron aftësitë në software-t grafike specifike në fushën e Arkitekturës

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 27.05.2026 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.